



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “NPT PRINTEKS” të datës 11.04.2023 kundër B58 njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me veshmbathje për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-23-1275-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 036 121, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “NPT PRINTEKS” të datës 11.04.2023 kundër B58 njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me veshmbathje për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-23-1275-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 036 121.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues për nënshkrim të kontratës duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën hyn në fuqi ky vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “NPT PRINTEKS” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “NPT PRINTEKS” (tutje “parashtruesi”) me datë 11.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër B58 njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues rivlerësim të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me veshmbathje për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-23-1275-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 036 121.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është i cituar si në vijim: *“Ne si OE jemi eliminuar per arsye se mosrat nuke plocojn kushtet e specifikave teknike e kerkuar ne Dosjen e Tenderit. Kuese ne kerkojm te deshmoni se apku me foto ato piket qe nuke plocojn kushtet, dhe OE-s Fitues te dergoni foto mosrave se jane Sipas Specifikave te kerkuar ne Dosjen e Tenderit. Ose na dergoni se në cilën institucion është certifikuar komisioni vlersues profesional per ta bërë testimi kualitet ose certifikatën e testimit materialeve të mosrave dorzuar nga Opertaët Ekonomik sa (%) është dallimi kualitet materialit Ngjyres ku bazohet Komisioni vlersimit Ose ndonje vertetim se komisioni eshte profesional per testimin uniformave”.*

Parashtruesi nuk ka paraqitur se cilat dispozita të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje si “LPP”) apo të legjislacionit sekondar mund të jenë shkelur në këtë rast.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- Raporti i vlerësimit të tenderëve i datës 04.04.2023;
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 07.04.2023;
- Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm i datës 07.04.2023.

Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 06.04.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimin e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohet pretendimi i parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nënparagrafi d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”) sipas elaborimeve në vijim.

Fillimisht duhet cekur se pretendimi i parashtruesit nuk është formuluar në mënyrë të kuptueshme dhe konkrete. Kjo pasi që parashtruesi ka kërkuar në emër të pretendimit të kërkesës për rishqyrtim, nuk ka paraqitur konstatimin e tij për shkeljet eventuale gjatë procedurës mirëpo ka kërkuar nga autoriteti kontraktues të dëshmoj te parashtruesi në forma të tjera B58 njoftimin mbi vendimin të autoritetit kontraktues. Fakti që parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim nuk ka treguar se cilat dispozita të LPP apo të RRPP janë shkelur, e bën pretendimin e parashtruesit mjaft paradoksal. Sidoqoftë, sa i përket dëshmive shtesë vizuale që ka kërkuar parashtruesi për të dëshmuar B58 njoftimin mbi vendimin të autoritetit kontraktues, duhet theksuar se në këtë rast janë përdorur formularët standard për të njoftuar vendimin e autoritetit kontraktues në përputhje me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi për prokurimin publik. Rrjedhimisht parashtruesi nuk ka treguar se mbi cilën bazë ligjore (dispozitë juridike në fuqi) ka kërkuar dëshmi vizuale shtesë për të konfirmuar dokumentin që e ka goditur me këtë kërkesë për rishqyrtim. Përderisa nuk ekziston një bazë ligjore e tillë, kjo kërkesë e parashtruesi është jo vetëm e panevojshme dhe e paligjshme, por edhe e pakuptimtë.

Faqe 2 nga 3

Adresa: Rr. “UÇK” nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Sa i përket pjesës tjetër të pretendimit të parashtruesit ku kërkohet të dëshmohet një certifikatë lidhur me përbërjen e komisionit vlerësues, fillimisht duhet cekur se parashtruesi nuk e ka sqaruar se për çfarë dokumenti bëhet fjalë saktësisht. Përndryshe as për këtë pjesë parashtruesi nuk ka treguar se mbi cilën bazë ligjore (dispozitë juridike në fuqi) është duke e kërkuar këtë dokument. Prandaj edhe për këtë pjesë të pretendimit, përderisa nuk ekziston një bazë ligjore, kërkesa e parashtruesit është e palejuar tërësisht. Ndërsa sa i përket arsyeve të eliminimit, nga administrimi i provave materiale është gjetur se parashtruesi i ka dorëzuar mostrat në kundërshtim me dosjen e tenderit. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument apo dëshmi për të vërtetuar të kundërtën e të gjeturave në raportin e komisionit vlerësues dhe provat tjera materiale të administruara. Përndryshe të gjitha arsyet për të cilat parashtruesi është eliminuar janë evidentuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar e cila është në përputhje me të gjeturat në raportin e komisionit vlerësues të datës 04.04.2023.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 14.04.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.